

VENDIM
Nr. 280, datë 4.5.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE NDËRTIMIT TË
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR
ZHVILLIM TË DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 3.3 shtohet pika 3.4, me këtë përmbajtje:

“3.4. Përdorimi i fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2023, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë pa TVSH, i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin ‘Shpenzime kapitale me financim të brendshëm’, të programit 06210 ‘Programe zhvillimi për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë’.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku